



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

UDHËZUESI DHE KRITERET PËR APLIKANTËT E GRANTEVE
MZHR/2021

Skema e Granteve „Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike 2021“ Masa 15 (Lot II dhe Lot III)

Autoriteti kontraktues:

Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR)

Afati për dorëzimin e aplikacionit:
Nga 05 Mars deri më 25 Mars 2021 ora 16:00

Përmbajtja

1. SKEMA E GRANTEVE „Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike 2021“ Masa 15.....	3
1.1. Hyrje	3
1.2. Grant/skema „Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike“Masa 15.....	3
1.3. Synimet e Thirrjes për Propozime	3
1.4. Përkrahja financiare e ofruar nga autoriteti kontraktues (MZHR)	4
1.5 Shumat e granteve	4
2. RREGULLAT PËR THIRRJEN PËR PROPOZIME	4
2.1 Kualifikimi i aplikantëve: kush mund të aplikojë?	5
2.2 Aplikantët që nuk kualifikohen	5
2.3 Veprimet e kualifikueshme: veprimet për të cilat mund të parashtrohet aplikimi	5
2.4 Sektorët apo temat	5
2.5 Lokacioni.....	6
2.6 Llojet e veprimit/projektit	6
2.6 Numri i aplikimeve dhe granteve për aplikant	6
2.7 Kualifikueshmëria e shpenzimeve: kostot që mund të merren parasysh për grantin	7
2.8 Procedurat e prokurimit.....	8
2.9 Kohëzgjatja	8
2.10. Kushtet e pagesës së grantit.....	8
3. SI TË APLIKOHET DHE PROCEDURAT QË DUHEN NDJEKUR	8
3.1 Mënyra e aplikimit	8
3.2 Ku dhe si të bëhet aplikimi	10
3.3 Afati i fundit për aplikim.....	10
3.4 Informata të mëtutjeshme për aplikimin	10
4. Kriteret e Vlerësimit.....	10
5. ANKESAT	11
6. LISTA E SHTOJCAVE	11

1. SKEMA E GRANTEVE „Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike 2021“ Masa 15

1.1. Hyrje

Situata e krijuar me COVID 19 ka shtyrë Qeverinë e Republikës së Kosovës që të ndërmarr masa për rimëkëmbje ekonomike. Me qëllim të adresimit të kësaj sfide Qeveria e Kosovës ka hartuar pakon e rimëkëmbjes ekonomike. Programi për Rimëkëmbje Ekonomike, i cili derivon nga Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitet 2020-2023, i aprovuar në Qeveri më 05.06.2020 me nr.01/02, ka për qëllim ruajtjen e shëndetit publik dhe ekonomik të vendit, gjithashtu. Pasi që COVID-19 tashmë ka shkaktuar një dëm të konsiderueshëm ekonomik, duke ndikuar negativisht në prodhim, punësim, të ardhura dhe eksporte, këto masa dhe ky program kanë për qëllim përsheptimin e rimëkëmbjes ekonomike. Me miratimin e Ligjit për Buxhetin 2021, është krijuar program i veçantë, Programi për Rimëkëmbjen Ekonomike, ku janë alokuar mjetet që do të dedikohen për qëllime të mbështetjes ekonomike dhe sociale për të tejkaluar pasojat e pandemisë. Ministria e Zhvillimit Rajonal, sipas Vendimit Nr. 06/58 të datës 14.01.2021 të Qeverisë, është përcaktuar përgjegjëse për zbatimin e Masës 15, për “Mbështetjen e programeve ekzistuese që lidhen me zhvillimin rajonal e që ndikojnë në zhvillimin rajonal të balancuar”. Marrë parasysh këtë vendim dhe Ligjin Nr. 07/L - 16 për Rimëkëmbje Ekonomike – COVID 19, MZHR ka realizuar konsultime me akterë të ndryshëm për dizajnimin e kësaj skeme, si: Oden Ekonomike të Kosovës, Klubin e Prodhuesve, Oden Tregtare Kosovarë - Turke, si dhe pesë Agjensionet Rajonale Zhvillimore.

1.2. Grant/skema „Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike“Masa 15

MZHR me lansimin e grant skemes për financimin e sektorit privat do të ndihmojmë atyre që të plotësojnë nevojat e tyre e të bërit biznes.

Synimi kryesor i skemës së granteve për sektorin privat është të mundësojë që projektet cilësore afariste të implementohen e zhvillohen ma tej, duke krijuar vende të reja të punës, e të cilat do të gjenerohen nga rritja e ndërmarrjeve ekzistuese që janë të alokuara në sektorët që kanë potencial më të madhë për rritje. Në disa raste fokusi do të jetë në nënsektorë në kuadër të sektorit ekzistues.

Ofrimi i ndihmës përmes grantit të lansuar nga ana e MZHR-së për ndërmarrjet në rritje në këta sektorët do të ketë ndikim pozitivë në krijimin e vendeve të reja të punës.

1.3. Synimet e Thirrjes për Propozime

Synimi i përgjithshëm i kësaj Thirrjeje për Propozime është zhvillimi socio-ekonomik rajonal të balansuar përmes zhvillimit të ndërmarrësisë në pesë rajonet zhvillimore të Kosovës të prekura nga pandemia COVID 19.

Synimet specifike të kësaj Thirrjeje për Propozime janë:

- i. Stimulimi i bizneseve për ndërprerjen e largimit të punëtorëve nga puna si rezultat i krizës së shkaktuar nga Pandemia Covid 19 e në raste të caktuara edhe krijimi i vendeve të reja të punës, me theks të veçantë për të rinjtë;
- ii. Përkrahja e zhvillimit të bizneseve të reja dhe atyre me potencial rritjeje;
- iii. Përkrahja e bizneseve që kontribuojnë në zëvendësimin e importeve.

1.4. Përkrashja financiare e ofruar nga autoriteti kontraktues (MZHR)

Shuma e përafërt e kësaj thirrje është rreth 1 milion €, gjithsesi Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën të mos shpërndajë të gjitha mjetet në dispozicion.

Granti do të ndahet në dy Lot, si vijon:

- **Loti 2 – Ndërmarrjet mikro dhe të vogla (Të regjistruara para datës 01.01.2021)** si dhe duhet të kenë qarkullim minimumi 7,001.00€ deri në 15,000.00 € të dëshmuara/deklaruar në ATK për vitin e fundit fiskal (2020).
- **Loti 3 – Ndërmarrjet mikro dhe të vogla (Të regjistruara para datës 01.01.2021)** si dhe duhet të kenë qarkullim mbi 15,001.00 deri në 500,000.00€ të dëshmuara/deklaruar në ATK për vitin e fundit fiskal (2020).

Sqarim:

Ndërmarrjet mikro dhe të vogla kategorizohen si në vijim:

1. Ndërmarrjet mikro prej 0-9 punëtor;
2. Ndërmarrjet e vogla prej 10-49 punëtor.

1.5 Shumat e granteve

Çdo grant i kërkuar sipas kësaj Thirrjeje për Propozime duhet të jetë brenda **shumave vijuese minimale dhe maksimale**:

Loti 2 – Ndërmarrjet mikro dhe të vogla
Nga 5,000.00 € deri në 10,000.00 €;

Loti 3 – Ndërmarrjet mikro dhe të vogla
Nga 10,001.00 € deri në 15,000.00 €;

Secili grant i kërkuar sipas kësaj Thirrjeje për Propozime duhet të jetë brenda **përqindjeve minimale dhe maksimale të kostos totale të kualifikueshme** për veprim: Për të gjitha lotet, përqindja e bashkëfinancimit nga aplikantët duhet të jetë nga 10% deri në 40%, gjithashtu kontributi në natyrë nuk konsiderohet bashkëfinancim. Shuma që kërkohet nga Autoriteti Kontraktues nuk mund të jetë nën 60% e kostos totale të projekt propozimit. Nëse gjatë realizimit të blerjeve, përfituesi ka arritë ta implementojë projektin më çmime më të vogla se ato të planifikuara atëherë mund të zbritet bashkëfinancimi deri në vlerën minimale të lejuar, por nëse projekti është implementuar edhe nën vlerën e bashkëfinancimit minimal atëherë zbritet edhe shuma e financimit të MZHR-së në mënyrë proporcionale për tu siguruar që projekti bashkëfinancohet nga përfituesi me vlerën minimale prej 10%.

2. RREGULLAT PËR THIRRJEN PËR PROPOZIME

Këto udhëzime përcaktojnë rregullat për dorëzimin, përzgjedhjen dhe implementimin e projekteve (veprimeve) të financuara sipas kësaj Thirrjeje për Propozime. Ekzistojnë tri tërësi të kritereve për kualifikim, që kanë të bëjnë me:

- Aplikanti (ët) që mund të kërkojnë grant;
- Veprimet (lloji i projektit të biznesit) për të cilin mund të jepet granti;
- Lloji i kostos që mund të merret në përcaktimin e shumës së grantit.

2.1 Kualifikimi i aplikantëve: kush mund të aplikojë?

Për t'u kualifikuar për grant, aplikantët **duhet**:

- Të jenë shtetas të Kosovës.
- Të jetë ndërmarrje në pronësi 100% *p r i v a t e* (sipas definicionit të Kosovës) regjistruar në Kosovë sipas ligjeve të Kosovës.¹
- Të jetë i regjistruar për aktivitetet e parapara me veprimin e propozuar para aplikimit për grant;
- Të mund të demonstrojë që të gjitha kontributet dhe tatimet janë përmbushur;
- Të jetë drejtpërdrejt përgjegjës për përgatitjen dhe menaxhimin e veprimeve.

2.2 Aplikantët që nuk kualifikohen

Aplikantë potencialë nuk mund të marrin pjesë në Thirrje për propozime apo të përfitojnë grante nëse gjenden në ndonjërin prej situatave që renditen si më poshtë:

- Kanë bankrotuar apo janë në mbyllje, janë nën administrim të gjykatave, kanë hyrë në marrëveshje me kreditorë, kanë pezulluar aktivitetet afariste, i janë nënshtruar procedurave në lidhje me këto çështje, ose janë në situata analoge që lindin nga procedurat e përcaktuara me legjislacion apo rregullore vendore;
- Ata, apo personat që kanë autorizim përfaqësimi, vendim-marrjeje apo kontrolli mbi ta, janë dënuar për një vepër që ka të bëjë me sjelljen profesionale me aktgjykim të një autoriteti kompetent (pra kur nuk ka mundësi apelimi);
- Nuk janë në përputhje me obligimet e tyre sa i përket pagesës së kontributeve apo pagesës së tatimeve në pajtim me dispozitat ligjore të vendit në të cilin janë themeluar;
- Ata, apo personat që kanë autorizim përfaqësimi, vendim-marrjeje apo kontrolli mbi ta, kanë qenë subjekt i një aktgjykimi të prerë e të plotfuqishëm për mashtrim, korrupsion, përfshirje në organizatë kriminale, shpëlarje të parave apo ndonjë aktivitet tjetër të paligjshëm, ku aktiviteti i tillë i paligjshëm është dëmtues për interesat financiarë të Kosovës;

2.3 Veprimet e kualifikueshme: veprimet për të cilat mund të parashtrohet aplikimi

Definicioni:

Veprimi (apo projekti) përbëhet nga një tërësi aktivitatesh.

Kohëzgjatja:

Kohëzgjatja e planifikuar e projektit që financohet nga MZHR nuk mund të tejkalojë 6 muaj (përveq nëse ndryshe parashihet me kushtet kontratë).

2.4 Sektorët apo temat

Ndërmarrjet që operojnë në prodhimin dhe përpunimin e produkteve, si dhe në shërbimet komerciale janë të kualifikuara të aplikojnë. Interes i veçantë i kushtohet projekteve që kanë mundësi të zëvendësojnë importet, dhe të krijojnë eksporte që mbulojnë nevojat dhe prioritetet e mjedisit lokal.

- Tregtia (me pakicë e shumicë),
- Ndërtimtaria,

¹ Certifikatën e regjistrimit të biznesit me të gjitha informatat përcjellëse sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës, certifikata duhet të jetë e re lëshuar nga ARBK sipas numrit unik identifikues.;

- Bujqësia (përfshijë pajisjet/makineritë për prodhimin dhe përpunimin e produkteve) dhe
- Shëndetsia, janë sektore që NUK KUALIFIKOHEN

2.5 Lokacioni

Aplikantët me Bizneset e tyre veprimtarinë duhet ta zhvillojnë në Republikën e Kosovës.

2.6 Llojet e veprimit/projektit

Propozimet për financim duhet të jenë të pavarura teknikisht dhe financiarisht. Veprimet duhet të kenë ndikim të prekshëm dhe të dukshëm tek kompanitë dhe rritjen e punësimit, rritjen e kapaciteteve prodhuese, përmirësim apo optimizim të cikleve jetësore të zhvillimit të produkteve/shërbimeve dhe diversifikimin e produkteve/shërbimeve, kanale të reja të shitjes dhe shpërndarjes, rritje të shitjes në Kosovë apo tregje ndërkombëtare, zhvillimin e zinxhirit të vlerave dhe të ngjashme.

Llojet vijuese të aktiviteteve në përputhje me synimet e Programit llogariten si **shpenzime të kualifikueshme, dhe mund të financohen sipas kësaj Thirrjeje për Propozime:**

- Investimet në asete të prekshme që kanë të bëjnë ose me blerjen e pajisjeve, makinerisë, linjat e prodhimit, softuerë, automatizim të proceseve dhe të ngjashme apo/ dhe përmirësimin e proceseve dhe metodave prodhuese si dhe duke përfshirë asetet që mund t'i ndihmojnë kompanive të jenë më pak të varura nga faktorët e jashtëm;
- Trajnimi i specializuar në lidhje me investimet e lartpërmendura, p.sh. trajnime për përdorimin e pajisjeve apo teknologjisë së re (kjo komponent nuk mund të kalojë më shumë se 5% të vlerës totale të projektit);
- Aktivitete marketingu (p.sh. pjesëmarrja në panairë, si dhe/ose zhvillimi i uebfaqeve, etj.) për të promovuar produkte e shërbime më të mira apo të reja (kjo komponent nuk mund të kalojë më shumë se 10% të vlerës totale të projektit).

Llojet vijuese të veprimit NUK kualifikohen:

- Veprimet që kanë të bëjnë vetëm me apo kryesisht me sponsorizimet individuale për pjesëmarrje në punëtori, seminare, konferenca;
- Veprimet që kanë të bëjnë vetëm me apo kryesisht me bursat individuale për studime apo kurse trajnimi;
- Programet për kredi;
- Detyrat dhe veprimet operative që nuk lidhen me implementimin e projektit;
- Aktet që shkelin rregullat dhe rregulloret e njohura ndërkombëtarisht të cilat mbrojnë të drejtat e punëtorëve në Kosovë.

Projekti duhet të jetë në përputhje me objektivat dhe prioritetet e ThpP dhe të garantojë dukshmërinë e financimit nga MZHR.

2.6 Numri i aplikimeve dhe granteve për aplikant

Një aplikant **nuk mund të dorëzojë më shumë se një aplikacion** në këtë Thirrje për Propozime.

2.7 Kualifikueshmëria e shpenzimeve: kostot që mund të merren parasysht për grantin

Të gjitha shpenzimet duhet të jenë në përputhje me rregullat e përcaktuara me këtë thirrje. Vetëm «kostot e kualifikuara» mund të merren parasysht për grant. Kostot e kualifikueshme duhen bazuar në shpenzime reale dhe dokumentet mbështetëse.

Kostot e kualifikueshme janë:

- Kostot që kanë të bëjnë me implementimin e aktiviteteve të kualifikuara;
- Janë shënuar në buxhetin e përgjithshëm të projektit;
- Janë të domosdoshme për implementimin e projektit;
- Janë të identifikueshme dhe të verifikueshme, në veçanti të regjistruara në regjistrat e kontabilitetit të Përfituesit(ve);
- Janë të arsyeshme, të arsyetuara brenda kërkesave të menaxhimit të qëndrueshëm financiar, sidomos në lidhje me ekonomizimin dhe efikasitetin.

Kostot e pakualifikueshme:

Kostot vijuese nuk kualifikohen:

- Borxhet dhe tarifat e mbulimit të borxhit;
- Provizionet për humbje dhe detyrime potenciale të ardhme;
- Interesat e borxhit;
- Tatimet në të hyra;
- Shpenzimet e deklaruara nga përfituesi dhe të mbuluara nga ndonjë veprim apo program tjetër pune;
- Blerja e tokës, ndërtimi apo riparimi i stabilimenteve/strukturave (përfshirë stabilimentet e depozitimit apo stabilimente/struktura të ngjashme);
- Humbjet në këmbim të valutës;
- Kreditë ndaj palëve të treta;
- Gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet gjyqësore;
- Kontributet në natyrë;
- Shpenzimet e amortizimit, që normalisht duhet të jenë pjesë e mënyrës në të cilën ndahen fitimet;
- Tarifat bankare, shpenzimet e garancive dhe tarifa të ngjashme;
- Kostot e artikujve apo pajisjeve të përdorura;
- Pagat dhe medijt;
- Shpenzimet e lëndës së parë;
- Shpenzimet tjera operationale (qiraja, rryma, uji etj.)
- Automjetet e transportit;
- Shpenzimet e transportit;
- Inventari (Tavolinat, karriget dhe dollapet, përjashtimit ato që ndërlidhen në mënyrë specifike me veprimtarinë)

Nëse kostot e pakualifikueshme arrijnë shumën mbi 20% të vlerës së projektit aplikacioni refuzohet. Shpenzimet e papranueshme janë çështje e përfituesit, prandaj ato nuk duhet të përfshihen në kërkesën për pagesë, kështu që përfituesi duhet të ketë mjete financiare vetanake për mbulimin e tyre.

Çdo tentim për mashtrim (psh. falsifikimi i faturave, manipulimi i procedurave të prokurimit, blerja e makinave apo pajisjeve të përdorura, etj.) do të ndëshkohet me

mospagesë të asaj pjese që është subjekt i mashtrimit dhe ndëshkime shtesë deri në përjashtim total nga pagesa, siç parashihet me sistemin ndëshkimor që është pjesë e kontratës. Është në interesin e aplikantit të paraqesë **buxhet realist dhe efektiv për koston**.

2.8 Procedurat e prokurimit

Procedurat e Prokurimit do të jenë pjesë e kontratës së nënshkruar në mes Autoritetit Kontraktues (MZHR) dhe përfituesit.

2.9 Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e planifikuar e projektit që financohet nga MZHR nuk mund të tejkalojë 6 muaj (përveq nëse ndryshe parashihet me kushtet e kontratës).

2.10. Kushtet e pagesës së grantit

Kushtet e pagesës do të përcaktohen me kontratë në mes MZHR-së dhe përfituesit.

3. SI TË APLIKOHET DHE PROCEDURAT QË DUHEN NDJEKUR

3.1 Mënyra e aplikimit

Aplikantet ftohen të plotësojnë formularin e aplikimit duke përdorur **formularin e aplikimit online të dizajnuar nga autoriteti kontraktues në sistemin [ekosova](https://ekosovacms.rks-gov.net/)**. Aplikantët duhet t'i përmbahen strikt formateve të aplikimit dhe të plotësojnë paragrafët dhe faqet me rend.

Pako e Aplikimit, në bazë të natyrës së biznesit të Aplikantit:

i) Pako aplikimi për LOT 2 PRE M15 2021 si dhe dokumentet që duhet të dorëzohen (për bizneset ekzistuese)

Shtojca A3 Formulari i aplikimit (plotësohet vetëm online përmes <https://ekosovacms.rks-gov.net/>)

Shtojca C1 Deklarata me shkrim nga aplikanti;;

Dokumentet tjera shtesë:

- Oferta për makinerinë apo pajisjet/ shërbimet e planifikuara në projekt për vlerën totale të projektit (*oferta duhet të përmbaj të dhënat e sakta të ofertuesit dhe nuk duhet të jetë më e vjetër se data e shpalljes së thirrjes për propozime si dhe duhet të ketë përputhje të plotë me buxhetin e propozuar në vlerë dhe përshkrim*).
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit me të gjitha informatat përcjellëse (fletat përcjellëse) sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës, certifikata duhet të jetë e re lëshuar nga ARBK sipas numrit unik identifikues;
- Listën e punëtorëve për vitin 2020 të lëshuar nga ATK (mund të nxirret online nga uebfaqja e ATK-së).
- Ofertat në valuta tjera duhet të bashkangjesin kursin me të cilin është kalkuluar.
- Aplikantët të cilët aplikojnë për Lot 2, si biznese ekzistuese duhet të plotësojnë sakt pjesën III pikën Nr. 1 në formularin e aplikacionit në ekosova lidhur me qarkullimin vjetor të v.2020, kjo do të kontrollohet nga MZHR në rast se parakualifikoheni dhe do të kërkohet të dëshmohet me vërtetim nga ATK.

ii) Pako aplikimi për LOT 3 PRE M15 2021 si dhe dokumentet që duhet të dorëzohen (për bizneset ekzistuese)

Shtojca A4 Formulari i aplikimit (plotësohet vetëm online përmes <https://ekosovacms.rks-gov.net/>)

Shtojca C1 Deklarata me shkrim nga aplikanti;

Dokumentet tjera shitesë:

- Oferta për makinerinë apo pajisjet/ shërbimet e planifikuara në projekt për vlerën totale të projektit (*oferta duhet të përmbaj të dhënat e sakta të ofertuesit dhe nuk duhet të jetë më e vjetër se data e shpalljes së thirrjes për propozime si dhe duhet të ketë përputhje të plotë me buxhetin e propozuar në vlerë dhe përshkrim*);
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit me të gjitha informatat përcjellëse (fletat përcjellëse) sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës, certifikata duhet të jetë e re lëshuar nga ARBK sipas numrit unik identifikues;
- Listën e punëtorëve për vitin 2020 të lëshuar nga ATK (mund të nxjerret online nga uebfaqja e ATK-së).
- Ofertat në valuta tjera duhet të bashkangjesin kursin me të cilin është kalkuluar.
- Aplikantët të cilët aplikojnë për Lot 2 dhe Lot 3, si biznese ekzistuese duhet të plotësojnë sakt pjesën III pikën Nr. 1 në formularin e aplikacionit në ekosova lidhur me qarkullimin vjetor të v.2020, kjo do të kontrollohet nga MZHR në rast se parakualifikoheni dhe do të kërkohet të dëshmohet me vërtetim nga ATK.

Vërejtje: Dokumentet e listuara me lart duhet të jenë me dukshmëri të qarte dhe të formatit PDF. Secili dokument duhet të vendoset në follderin përkatës (sipas emërimit) në të kundërtën aplikacioni llogaritet i pa kompletuar përkatësisht i plotësuar gabim, rrjedhimisht skualifikohet që në fazën e parë – Administrative.

Aplikacionet mund të plotësohen në gjuhën shqipe apo serbe në platformën [ekosova](#) online. **Aplikacionet e fizike apo të shkruara me dorë nuk do të pranohen.** Vetëm formularët e **PLOTËSUAR** të aplikimit dhe shtojcat do të kalojnë për vlerësim. Kështu, është me rëndësi kyçe që këto dokumente të përmbajnë TË GJITHA informatat relevante në lidhje me veprimin.

Vlerësimi i Aplikacioneve do të përfshijë një «kontroll administrativ» për të siguruar që aplikantët kanë përmbushur rregullat e kualifikimit (p.sh. aplikantët janë shtetas të Kosovës, si dhe biznesi është regjistruar në Kosovë për Lot 2 dhe Lot 3 (për biznes ekzistuese)). Procesi i vlerësimit përmbajtësor do të konsiderojë nëse Aplikacioni demonstroi që ndërmarrja ka perspektivë të mirë të të qenit e suksesshme dhe e qëndrueshme, si dhe që implementimi do të kontribuojë drejt përmbushjes së synimeve të Skemës së Granteve për të ndihmuar zhvillimin ekonomik të Kosovës. Grantet do t'i jepen aplikantëve «me notën më të lartë» në secilin Lot, deri në kufijtë e buxhetit në dispozicion.

Në rastet kur ka mos përputhje të vlerave buxhetore në projekt, konfuzitet në përshkrim të projektit dhe gabim në përdorimin e formateve të përcaktuara në thirrjen për propozime, projekti do të diskualifikohet.

MZHR nuk është përgjegjëse për koston që ndërlidhet me përgaditjen e aplikacionit, sikur që luten të gjithë aplikuesit që për çdo sqarim eventual lidhur me aplikim të shfrytëzojnë të gjitha mundësitë zyrtare të sqarimeve sipas orarit indikativ të publikuar nga MZHR.

Përfituesit (pronarët e bizneseve që kanë përfitur) nga skema **PZHRB 2019, PZHRB 2020** si dhe përfituesit e **Programit për Rimëkëmbje Masa 8 - 2020** nuk kanë të drejtë

aplikimi për këtë thirrje, si dhe edhe përfituesit që kanë dështuar në implementimin e projekteve nga këto skema.

Përfituesit nga **PZHRB 2018** nëse do të parakualifikohen do të verifikohen lidhur me përmbushjen e kushteve të projektit paraprak.

3.2 Ku dhe si të bëhet aplikimi

Aplikimi bëhet online përmes platformës eKosova, shih udhëzuesin e ASHI për mënyrë e aplikimit përmes [ekosova https://ekosovacms.rks-gov.net/](https://ekosovacms.rks-gov.net/) - Për Lot 2 dhe 3 (biznese ekzistuese) Aplikimi duhet të bëhet nga pronarët e bizneseve apo personat e autorizuar siç figurojnë në ARBK <https://arbk.rks-gov.net/page.aspx?id=1,1>.

Në rast se vërehet se të dhënat e llogarisë në [ekosova](https://ekosovacms.rks-gov.net/) nuk përputhen me të dhenat në aplikacion, MZHR do të diskualifikojnë atë aplikacion nga procesi i mëtutjeshëm.

3.3 Afati i fundit për aplikim

Afati i fundit për aplikim është **25 Mars 2021, në ora 16:00 në platformën [ekosova](https://ekosovacms.rks-gov.net/)** pas kësaj afati mbyllet sistemi elektronik i aplikimit. Aplikacionet fizike apo me postë nuk pranohen.

3.4 Informata të mëtutjeshme për aplikimin

Gjatë periudhës që fillon nga publikimi i këtyre udhëzimeve deri në afat, ngjarjet publike dhe seancat informuese lidhur me lansimin e këtyre fondeve për procedurën dhe kriteret e caktuara për aplikantët e interesuar i organizon Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR).

Megjithatë, mund të dërgohen pyetje shtesë në emailin vijues: ylber.citaku@rks-gov.net më së voni deri më 15 Mars 2021 deri në ora 16:00, si dhe duhet të tregojë qartë referencën për Thirrjen për Propozime si dhe Loti specifik të cilit i referohet. MZHR nuk ka për obligim të ofrojë qartësime të mëtutjeshme ndaj pyetjeve që dorëzohen pas datës 15 Mars 2021.

4. Kriteret e Vlerësimit

Për t'u para-selektuar, projekt propozimi duhet të arrijë së paku 50 pikë. Pas vlerësimit, aplikantët do të renditen sipas pikeve të tyre. Aplikimet me piket më të larta do të zgjedhen përkohësisht deri në arritjen e buxhetit në dispozicion.

Pjesa/ Elementet e notimit	Pesha e përgjithshme / Piket maksimale
	LOT 2 dhe LOT 3
1. Kapaciteti financiar dhe operacional	30
2. Relevanca e veprimit	20
3. Efektshmëria dhe arritshmëria	15
4. Qëndrueshmëria e veprimit	20
5. Buxheti dhe efektshmëria në kosto	15
GJITHSEJ PIKE (MAKSIMUM)	100

Pjesë e vlerësimit do të jetë edhe një anëtarë nga shoqëria civile në cilësinë e vëzhguesit.

5. ANKESAT

Pas publikimit të rezultateve aplikantët (ose të autorizuarit e tyre) mund të dorëzojnë ankesa në Arkivin e MZHR-së brenda 15 ditë (kalendarike) nga data e publikimit të rezultateve.

6. LISTA E SHTOJCAVE

i) Pako aplikimi për LOT 2 PRE M15 2021 (Biznes ekzistues)

Shtojca A3 Formulari i aplikimit PRE M15 2021 (Plotësohet vetëm online përmes <https://ekosovacms.rks-gov.net/>

Shtojca C1 Deklarata me shkrim nga aplikanti PRE M15 2021 e nënshkruar.

ii) Pako aplikimi për LOT 3 PRE M15 2021 (Biznes ekzistues)

Shtojca A4 Formulari i aplikimit PRE M15 2021 (Plotësohet vetëm online përmes <https://ekosovacms.rks-gov.net/>

Shtojca C1 Deklarata me shkrim nga aplikanti PRE M15 2021 e nënshkruar.